

**VENDIM**  
**Nr. 644, datë 3.8.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN  
E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË  
NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME, PËR  
KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI  
OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË  
TË RËNDA JOSTRUKTURE, NË BASHKITË LEZHË DHE DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 344 559 716 (treqind e dyzet e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme, për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe DS5), në bashkitë Lezhë dhe Durrës.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 63 483 700 (gjashtëdhjetë e tre milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi 281 076 016 (dyqind e tetëdhjetë e një milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore (DS4 dhe DS5).

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Lezhë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**